

Pyetje të shpeshta (Albanian)

1. Çfarë është Fair Fares NYC (FFNYC)?.....	4
2. A po kalon FFNYC-ja nga MetroCard në One Metro New York (OMNY)?	4
3. A duhet ta kaloj FFNYC MetroCard-in në OMNY?.....	4
4. A mund të transferoj para nga FFM-ja në kartën time FFNYC OMNY (FFOC)?.....	5
5. Si funksionon zbritja FFNYC?	5
6. Kush kualifikohet për të marrë pjesë?.....	6
7. Jam duke marrë pjesë aktualisht në programin e MTA-së me tarifë të reduktuar. A kualifikohem unë për zbritjen e FFNYC?	6
8. A ndikon statusi im i emigracionit në aftësinë time për të marrë pjesë në Fair Fares NYC?.....	6
9. Si mund të aplikoj për një zbritje të FFNYC-së?	7
10. Si ta zbuloj nëse aplikimi im është miratuar?	7
11. Për sa kohë mund të marr pjesë në programin FFNYC pasi të jem miratuar?	7
12. Kur do ta marr zbritjen time të FFNYC-së?	8
13. Jam miratuar për FFNYC, por nuk kam marrë një kartë OMNY me postë Si të veprojmë?	8
14. Kam vështirësi me faqen e internetit nyc.gov/accessfairfares . Si mund të kërkoj ndihmë?	8
15. Kam nevojë për ndihmë për të plotësuar aplikimin e FFNYC-së. Kush mund të më ndihmojë?	8
16. Unë e marr postën time në një zyrë postare të përgjithshme (P.O.). Si mund ta marr kartën Fair Fares OMNY	9
17. Si ta përditësoj adresën time postare?.....	9
18. Më është refuzuar aplikimi për Fair Fares. Si mund të marr më shumë informacion? ...	9
19. Çfarë dokumentesh do të më duhen për të verifikuar moshën, vendbanimin në qytetin e Nju-Jorkut dhe të ardhurat e mia?	9
20. Si t'i dorëzoj dokumentet për aplikimin tim?	9
21. U përpoqa t'i dorëzoja dokumentet, por nuk funksionoi. Si mund të kërkoj ndihmë?....	10
22. Si mund ta di nëse i keni marrë dokumentet e mia?	10
23. A ka afat për dorëzimin e dokumenteve?.....	10

24. Çfarë ndodh nëse nuk i dorëzohet dokumentet në kohë?	10
25. A duhet të krijohet një llogari OMNY?	11
26. Ku mund ta gjej numrin tim të serisë së FFOC-së?	11
27. Çfarë është numri i llogarisë tranzit të OMNY-t dhe ku mund ta gjej atë?	12
28. A mund ta përdorësh me zbritje FFOC-në, kartën e debitit ose kreditit, apo pajisjen time celulare një anëtar i familjes sime ose një mik?	12
29. A mund ta përdorësh kartën time Fair Fares me zbritje për në të gjitha sistemet e transportit publik të qytetit të Nju-Jorkut?	13
30. Si të shtoj para në FFOC-në time?	13
31. Çfarë është mbulimi i tarifës me FFOC-në time?	13
32. Çfarë duhet të bëj nëse më është tarifuar tarifa e plotë dhe jo tarifa e zbritur?	14
33. Kë duhet të telefonoj nëse kam një pyetje rreth një tarifimi në kartën time OMNY (jo në lidhje me pagesën e tarifës së plotë)?	14
34. A mund të përdorësh kartën time të kreditit ose të debitit, apo pajisjen celulare me zbritjen time të FF-së?	14
35. A mund të përdorësh dy karta krediti ose dy pajisje celulare të ndryshme me zbritjen time FF?	14
36. A mund të përdorësh disa karta udhëtimi në të njëjtën kohë?	15
37. Kë duhet të telefonoj nëse karta ime e kreditit ose debitit nuk funksionon?	15
38. A do të mbahet privat informacioni im?	15
39. Kam marrë njoftimin se regjistrimi im po përfundon për shkak se nuk kualifikohem më. Mendoj se ka ndodhur një gabim. Me kë mund të flas?	15
40. Sa kohë kam për të bërë kërkesë për shqyrtimin e përcaktimit të kualifikueshmërisë sime?	15
41. Çfarë ndodh nëse marr njoftimin se zbritja ime e FFNYC-së do të ndërpritet për shkak të keqpërdorimit ose veprimtarisë së paautorizuar?	16
42. Çfarë të bëj nëse marr një njoftim për bilanc të ulët?	16
43. Sa herë mund ta zëvendësoj FFOC-në time të humbur ose të vjedhur?	16
44. Si të veproj nëse FFOC-ja ime ka humbur, është vjedhur ose është dëmtuar?	16
45. Si të veproj nëse kam humbur kartën e kreditit, kartën e debitit ose pajisjen time celulare me zbritjen?	17
46. Si ta zhvendos bilancin nga karta ime OMNY e humbur, e vjedhur, e dëmtuar, e skaduar ose afër skadencës në kartën time të re OMNY?	17
47. Sa shpesh duhet ta rinovoj regjistrimin tim në FFNYC?	17
48. Si mund ta rinovoj regjistrimin tim në FFNYC?	18
49. A do të njoftohem kur duhet të bëj rinovim?	18
50. A ka një afat për rinovimin?	18

51. Çfarë ndodh nëse nuk e arrij afatin e rinovimit?	18
52. Si ta di nëse kualifikohem për FFNYC-në?.....	18
53. Po nëse adresa ime e re nuk është në qytetin e Nju-Jorkut?	18
54. Çfarë dokumentesh duhet të dorëzoj bashkë me aplikimin për rinovim?	19
55. A do të pajisem me një kartë të re Fair Fares NYC OMNY kur të bëj rinovimin?	19
56. A do të jem në gjendje të vazhdoj ta përdor zbritjen aktuale të FFNYC-së pasi të miratohet aplikimi im për rinovim?.....	19
57. Si mund ta kuptoj kur karta FFNYC është afër skadencës?	19
58. Çfarë ndodh nëse FFOC-ja ime skadon në më pak se 30 ditë?	19
59. Çfarë ndodh nëse karta ime e debitit ose e kreditit me zbritje skadon?	20
60. A mund të përdor një FFOC të skaduar nëse ka ende para brenda?	20

Rreth programit

1. Çfarë është Fair Fares NYC (FFNYC)?

Programi Fair Fares NYC (Tarifa të drejta NYC) është një program i qytetit, i krijuar për të ndihmuar banorët e Nju-Jorkut me të ardhura të ulëta që të menaxhojnë kostot e tyre të transportit. Përmes FFNYC-së, banorët e kualifikueshëm të qytetit të Nju-Jorkut marrin një zbritje prej 50% për tarifën e metrosë dhe të autobusëve të kualifikueshëm ose 50% zbritje për shërbimin e transportit individual Access-A-Ride (AAR).

Kthehuni në krye

2. A po kalon FFNYC-ja nga MetroCard në One Metro New York (OMNY)?

FFNYC-ja nuk lëshon më Fair Fares MetroCards (FFMs). Nëse keni një FFM, mund ta përdorni derisa të ndodhë një nga të mëposhtmet (cilado ndodh më herët):

- a) karta skadon (data e skadimit ndodhet në pjesën e pasme të kartës suaj);
- b) karta nuk funksionon më;
- c) karta çaktivizohet; ose
- d) ju nuk jeni më i regjistruar në programin Fair Fares.

Do të kaloni në OMNY në një nga mënyrat e mëposhtme:

1. Kur të rinovoni regjistrimin tuaj në program.
2. Nëse e raportoni kartën tuaj MetroCard si të humbur, të vjedhur ose të dëmtuar.
3. Ju mund të kaloni nga MetroCard në OMNY në çdo kohë në ACCESS HRA.

Kur të kaloni, mund të zgjidhni një kartë OMNY ose mund të përdorni kartën tuaj të kreditit ose të debitit ose një portofol dixhital.

Kthehuni në krye

3. A duhet ta kaloj FFNYC MetroCard-in në OMNY?

Po. OMNY është mënyra e re e pagesave dhe do të zëvendësojë MetroCard-in. Do t'ju duhet të përdorni OMNY për të udhëtuar në metrotë e NYC Transit dhe në autobusë lokalë, të kufizuar dhe të Select Bus Service (SBS), në Staten Island Railway, Roosevelt Island Tram dhe në shërbimin e autobusëve Hudson Rail Link.

Kthehuni në krye

4. **A mund të transferoj para nga FFM-ja në kartën time FFNYC OMNY (FFOC)?**

Nuk mund të transferoni para nga FFM-ja në FFOC. Megjithatë, çdo bilanc në FFM-në tuaj do të jetë në dispozicionin tuaj dhe mund të përdoret për të udhëtuar në metrotë dhe autobusët lokalë, të kufizuar dhe të Select Bus Service (SBS), në Staten Island Railway, Roosevelt Island Tram dhe në shërbimin e autobusëve Hudson Rail Link.

Duhet ta përdorni bilancin e mbetur në FFM para se të skadojë ose të anulohet. Thjesht kaloni FFM-në tuaj në të njëjtën mënyrë si sot. Nuk mund të transferoni asnjë bilanc të mbetur nga një MetroCard me tarifë të plotë ose një kartë OMNY me tarifë të plotë në një FFM ose FFOC.

[Kthehuni në krye](#)

5. **Si funksionon zbritja FFNYC?**

FFNYC-ja ju lejon të përfitonit zbritje 50% për tarifën e metrove, autobusëve të kualifikueshëm ose Access-A-Ride.

- **Metrotë dhe autobusët**

Me zbritjen tuaj të FFNYC-së, do të mund të udhëtoni në metrotë dhe autobusët e kualifikuar me gjysmë çmimi!

Nëse aplikoni ose kualifikoheni për FFNYC dhe zgjidhni zbritjen për metro ose autobus, qyteti do të shtojë zbritjen tuaj në një FFOC ose kartë krediti ose debiti, apo në një pajisje inteligjente të zgjedhur prej jush. FFOC-ja nuk do të ketë asnjë vlerë brenda. Nuk mund ta përdorni FFOC-në tuaj për të paguar tarifën derisa të shtoni para në të.

Këto janë mënyrat se si mund të shtoni para në FFOC:

1. Në një stacion metroje, duke përdorur një makinë shityesh për kartat OMNY (mjafton të preknit kartën tuaj në ekran për të filluar);
2. Në një dyqan, farmaci, ose pikë të tërheqjes së parave nga çeku në lagjen tuaj (vizitoni faqen [omny.info/retail](https://www.omny.info/retail) për të gjetur një pranë jush);
3. Në internet ose me telefon me një llogari OMNY. Krijoni një llogari falas në faqen [omny.info/register](https://www.omny.info/register) ose telefononi numrin 877-789-6669.

Preknit kartën tuaj OMNY, kartën e kreditit ose të debitit, apo pajisjen celulare në lexuesin OMNY në autobus ose metro dhe do të zbritet gjysma e tarifës aktuale. Sa herë që preknit kartën tuaj, do të tarifoheni vetëm për gjysmën e çmimit aktual për një udhëtim të vetëm.

- **Access-A-Ride (AAR)**

Klientët e AAR-së nuk përdorin FFOC. Zbritja e tyre zbatohet automatikisht! Kartat AAR shpërndahen nga Autoriteti i Transportit Metropolitan (MTA)-ja. Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me AAR-në, vizitoni [faqen e internetit](#) ose telefononi numrin 877-337-2017.

[Kthehuni në krye](#)

Kualifikueshmëria

6. Kush kualifikohet për të marrë pjesë?

Banorët e qytetit të Nju-Jorkut (NYC) mund të kualifikohen për FFNYC nëse:

1. Janë midis moshave 18 dhe 64.
2. Janë pjesë e një familjeje që përmbush udhëzimet në lidhje me të ardhurat për programin FFNYC.
3. Nuk marrin tarifë transporti të plotë nga Departamenti i Shërbimeve Sociale/Administrata e Burimeve Njerëzore (Department of Social Services, DSS/Human Resources Administration, HRA) ose ndonjë agjenci tjetër e qytetit të Nju-Jorkut; dhe
4. Nëse zgjidhni zbritjen e FFNYC-së për metro dhe autobusë, nuk po merrni pjesë ose nuk jeni të kualifikueshëm për të marrë pjesë në një program tjetër për zbritje të tarifave të transportit.

Kthehuni në krye

7. Jam duke marrë pjesë aktualisht në programin e MTA-së me tarifë të reduktuar. A kualifikohem unë për zbritjen e FFNYC?

Jo. Nuk kualifikoheni për zbritjen për metro dhe autobus të FFNYC-së nëse merrni pjesë ose kualifikoheni të merrni pjesë në programin e MTA-së me tarifë të reduktuar. Nëse jeni një klient i Access-A-Ride, mund të kërkonti që zbritja e FFNYC-së të zbatohet për tarifën AAR.

Mund të mësoni më shumë rreth këtyre programeve në <https://mta.info/reduced-fare>.

Kthehuni në krye

8. A ndikon statusi im i emigracionit në aftësinë time për të marrë pjesë në Fair Fares NYC?

Jo. Fair Fares NYC nuk do t'ju pyesë rreth statusit tuaj të emigracionit dhe nuk do të regjistrojë asnjë informacion në lidhje me këtë.

Kthehuni në krye

Aplikimi dhe marrja e zbritjes së Fair Fares NYC

9. Si mund të aplikoj për një zbritje të FFNYC-së?

Të gjithë banorët e qytetit të Nju-Jorkut mund të aplikojnë për një zbritje të FFNYC-së. Vizitoni faqen nyc.gov/accessfairfares për të mësuar më tepër dhe për të aplikuar.

Mund t'ju kërkohet të jepni të dhënat tuaja personale për sa i përket:

- Identitetit;
- Vendbanimit; dhe
- Të ardhurave

Mund t'ju kërkohet të dërgoni dokumentacion mbështetës. Vizitoni nyc.gov/fairfares për të parë listën e dokumenteve të sugjeruara të Fair Fares NYC.

[Kthehuni në krye](#)

10. Si ta zbuloj nëse aplikimi im është miratuar?

Pasi aplikimi juaj të jetë dërguar dhe të gjitha dokumentet të jenë ngarkuar, prisni deri në 30 ditë për shqyrtimin e aplikimit tuaj. Mund të identifikoheni në llogarinë tuaj në nyc.gov/accessfairfares për të kontrolluar statusin e aplikimit tuaj. Pasi aplikimi juaj të jetë shqyrtuar, do të njoftoheni me postë.

[Kthehuni në krye](#)

11. Për sa kohë mund të marr pjesë në programin FFNYC pasi të jem miratuar?

Do të regjistroheni për një vit nga data kur aplikimi juaj të miratohet, nëse vazhdoni të përmbushni kriteret e kualifikimit.

[Kthehuni në krye](#)

12. Kur do ta marr zbritjen time të FFNYC-së?

Karta Fair Fares OMNY: Pasi aplikimi juaj të miratohet, prisni dy deri në tre javë për dërgimin e FFOC-së suaj me postë përmes Shërbimit Postar të Shteteve të Bashkuara (United States Postal Service, USPS).

Karta juaj e debitit ose kreditit, apo karta OMNY: Zbritja do të shtohet menjëherë pasi aplikimi juaj të miratohet. Programi Fare Fares do t'ju lajmërojë pasi zbritja të jetë aktive. Zbritja gjithashtu mund të shihet në profilin e llogarisë suaj OMNY nëse shtoni kartën në llogarinë tuaj. Zbritja duhet të jetë aktive brenda 24 orësh.

Access-A-Ride: Nëse zgjidhët zbritjen AAR, nuk do të merrni një kartë OMNY nga Fair Fares. Në vend të saj, do të merrni kartën tuaj AAR OMNY ID nga MTA-ja.

[Kthehuni në krye](#)

13. Jam miratuar për FFNYC, por nuk kam marrë një kartë OMNY me postë Si të veprojmë?

Nëse kanë kaluar më shumë se 3 javë që kur jeni miratuar dhe nuk e keni marrë FFOC-në, telefononi numrin 311 ose raportojeni kartën tuaj si "humbur në postë" në [Access HRA](#).

[Kthehuni në krye](#)

14. Kam vështirësi me faqen e internetit [nyc.gov/accessfairfares](https://www.nyc.gov/accessfairfares). Si mund të kërkoj ndihmë?

Nëse keni probleme teknike me [nyc.gov/accessfairfares](https://www.nyc.gov/accessfairfares), ju lutemi vizitoni faqen [Ndihmë për ACCESS HRA](#) për përgjigje ndaj problemeve të hasura më shpesh ose telefononi numrin 311 për ndihmë.

[Kthehuni në krye](#)

15. Kam nevojë për ndihmë për të plotësuar aplikimin e FFNYC-së. Kush mund të më ndihmojë?

Vizitoni një nga pikat e Fair Fares NYC dhe stafi i FFNYC-së do t'ju ndihmojë me aplikimin tuaj. Vizitoni faqen www.nyc.gov/fairfares dhe klikoni "[Na kontaktoni](#)" për një listë të vendndodhjeve të Fair Fares NYC. Mund të telefononi edhe numrin 311 për më shumë informacion.

[Kthehuni në krye](#)

16. Unë e marr postën time në një zyrë postare të përgjithshme (P.O.). Si mund ta marr kartën Fair Fares OMNY

Nëse aplikimi ose rinovimi juaj miratohet dhe mund të përdorni një kuti postare brenda pesë zonave të qytetit të Nju-Jorkut për të marrë postën, ne do t'ju dërgojmë FFOC-në në kutinë tuaj postare që ndodhet brenda pesë zonave të qytetit të Nju-Jorkut.

[Kthehuni në krye](#)

17. Si ta përditësoj adresën time postare?

Vizitoni faqen [nyc.gov/accessfairfares](https://www.nyc.gov/accessfairfares) për të përditësuar adresën postare në profilin tuaj.

[Kthehuni në krye](#)

18. Më është refuzuar aplikimi për Fair Fares. Si mund të marr më shumë informacion?

Aplikimi juaj mund të refuzohet nëse nuk i përmbushni kërkesat e kualifikueshmërisë. Mund të vizitoni www.nyc.gov/accessfairfares për të parë arsyen për refuzimin e aplikimit. Njoftimi që morët shpjegon arsyen se përse nuk kualifikoheni për FFNYC. Nëse mendoni se kemi bërë një gabim, vizitoni faqen e internetit në <https://www.nyc.gov/site/fairfares/contact-us/contact-us.page> për një vendndodhje zyre ose telefononi numrin 311 për të kërkuar shqyrtimin e aplikacionit tuaj.

[Kthehuni në krye](#)

Si të dorëzoni dokumentet e aplikimit dhe pyetje të tjera të ngjashme

19. Çfarë dokumentesh do të më duhen për të verifikuar moshën, vendbanimin në qytetin e Nju-Jorkut dhe të ardhurat e mia?

Referojuni [listës së dokumenteve të sugjeruara të Fair Fares NYC](#).

[Kthehuni në krye](#)

20. Si t'i dorëzoj dokumentet për aplikimin tim?

Përdorni aplikacionin celular të ACCESS HRA-së për të ngarkuar dokumentet për FFNYC-në. Shkoni te [nyc.gov/ffdocs](https://www.nyc.gov/ffdocs) për të shkarkuar aplikacionin ACCESS HRA, për t'u identifikuar në llogarinë tuaj si dhe për të dorëzuar dokumentet tuaja. Nëse nuk mund ta përdorni aplikacionin tuaj celular, mund të vini në [një zyrë](#) të FFNYC-së dhe të merrni ndihmë me ngarkimin e dokumenteve tuaja.

[Kthehuni në krye](#)

21. U përpoqa t'i dorëzoja dokumentet, por nuk funksionoi. Si mund të kërkoj ndihmë?

Provoni të dilni nga llogaria juaj dhe më pas të identifikoheni sërish në të. Mund të duhen deri në 15 minuta që dokumentet të shfaqen. Nëse ende keni vështirësi, mund të paraqiteni në njërën nga zyrat e Fair Fares NYC dhe të merrni ndihmë me ngarkimin e dokumenteve tuaja.

[Kthehuni në krye](#)

22. Si mund ta di nëse i keni marrë dokumentet e mia?

Fair Fares do t'ju dërgojë një mesazh me tekst nëse aplikimi juaj nuk është i plotë. Gjithashtu, mund të identifikoheni sërish në llogarinë tuaj në faqen nyc.gov/accessfairfares për të kontrolluar dokumentet që janë ende të nevojshme dhe afatin e dorëzimit.

[Kthehuni në krye](#)

23. A ka afat për dorëzimin e dokumenteve?

Keni 10 ditë kohë për të dorëzuar dokumentet pasi të dërgoni aplikimin tuaj. Identifikohuni në llogarinë tuaj në faqen nyc.gov/accessfairfares për të kontrolluar statusin e aplikimit tuaj dhe për të parë se sa kohë ju ka mbetur për të dorëzuar dokumentet.

[Kthehuni në krye](#)

24. Çfarë ndodh nëse nuk i dorëzoj dokumentet në kohë?

Nëse nuk i marrim dokumentet tuaja në kohë, do t'ju duhet të dërgoni një aplikim të ri.

[Kthehuni në krye](#)

Përdorimi i zbritjes suaj të Fair Fares NYC

25. A duhet të krijosh një llogari OMNY?

Po. Krijimi i një llogarie OMNY është opsional, por është tepër e rekomandueshme. Një llogari OMNY është e sigurt dhe ofron disa përfitime:

- Gjurmimin e ecurisë suaj drejt përfitimit të transportit falas me tarifën maksimale për 7 ditë
- Rimbushjen e kartës suaj
- Konfigurimin e rimbushjeve automatike në mënyrë që të mos shqetësoheni për një bilanc të ulët.
- Menaxhimin e mënyrës së pagesës
- Marrjen e njoftimeve nga llogaria
- Anulimin e menjëhershëm të kartës suaj nëse humb ose vidhet.
- Dhe më shumë!

Për t'u regjistruar në një llogari OMNY, vizitoni faqen <https://omny.info/register>. Nëse ju duhet ndihmë me konfigurimin e një llogarie OMNY, shihni këtë [video udhëzuese në YouTube](#).

Nëse ju duhet ndihmë për t'u regjistruar në një llogari OMNY, kontaktoni shërbimin ndaj klientit të OMNY-t duke telefonuar në numrin 877-789-6669.

[Kthehuni në krye](#)

26. Ku mund ta gjej numrin tim të serisë së FFOC-së?

Numri juaj i serisë i FFOC-së është numri 18-shifror në pjesën e pasme të kartës OMNY. Këtë numër duhet ta mbani shënim.

[Kthehuni në krye](#)

27. Çfarë është numri i llogarisë tranzitit i OMNY-t dhe ku mund ta gjej atë?

Numri juaj i llogarisë tranzitit të OMNY-t lidhet me gjithçka që ju bëni në llogarinë tuaj OMNY. Shërbimi ndaj klientit i OMNY-t mund t'ju kërkojë këtë numër nëse i kontaktoni për ndihmë.

Ka katër mënyra se si mund ta gjeni numrin e llogarisë tranzitit:

1. Duke u identifikuar në llogarinë tuaj të Access HRA-së.
2. Duke u regjistruar për një llogari OMNY në faqen omny.info/register dhe duke lidhur FFOC-në tuaj ose kartën e debitit ose kreditit.
3. Duke telefonuar në numrin 311.
4. Mjeti i kërkimit të llogarisë tranzitit në Access HRA – disponohet kur ndërmerren masa në lidhje me çështjen.
 - a. **Çfarë është ky mjet?** – Është një mënyrë e sigurt për të parë numrin tuaj të llogarisë tranzitit.
 - b. **A është e sigurt që ta vendos informacionin e kartës sime të kreditit në këtë mjet?** – Po. Kjo është një faqe interneti e sigurt.
 - c. **Çfarë të bëj nëse marr një mesazh gabimi?** – Nëse merrni një mesazh gabimi, mbyllni dritaren dhe provoni përsëri.

[Kthehuni në krye](#)

28. A mund ta përdorë me zbritje FFOC-në, kartën e debitit ose kreditit, apo pajisjen time celulare një anëtar i familjes sime ose një mik?

Jo. Zbritja juaj e FFNYC-së është vetëm për përdorim personal. FFOC-në tuaj nuk mund ta ndani ose t'ja jepni hua anëtarëve të familjes, miqve apo dikujt tjetër. Ju gjithashtu nuk mund ta ndani ose të jepni hua një kartë debiti, kartë krediti ose pajisje celulare që përmban zbritje. Nuk mund t'ua a shisni kartën ose transaksionet askujt. Shkelja e këtij rregulli konsiderohet keqpërdorim i kartës ose mashtrim dhe mund të rezultojë në një pezullim 60-ditor të FFOC-së suaj. Nëse e shkelni këtë rregull për herë të dytë, do të përjashtoheni përgjithmonë nga programi Fair Fares NYC.

[Kthehuni në krye](#)

29. A mund ta përdor kartën time Fair Fares me zbritje për në të gjitha sistemet e transportit publik të qytetit të Nju-Jorkut?

Mund ta përdorni zbritjen tuaj të Fair Fares për:

1. Metronë e qytetit të Nju-Jorkut dhe autobusët e kualifikuar,
2. Staten Island Railway,
3. Roosevelt Island Tram dhe
4. Hudson Rail Link.

Kur OMNY të bëhet i disponueshëm në autobusët e Westchester Bee-Line (WBL) dhe Nassau Inter-County Express (NICE), atëherë do të mund ta përdorni zbritjen e FFNYC-së edhe për këto shërbime.

Zbritja juaj e Fair Fares ose OMNY **nuk** mund të përdoret për sa më poshtë:

1. MetroNorth Railroad
2. Long Island Rail Road
3. Port Authority Trans-Hudson (PATH)

Karta ose pajisja juaj do të funksionojë për autobusët MTA ekspres dhe AirTrain JFK, por ju do të paguani **tarifë të plotë** për ato shërbime.

Kthehuni në krye

30. Si të shtoj para në FFOC-në time?

Po ju paraqesim mënyrat se si mund t'i shtoni para FFOC-së suaj kur ta merrni:

- Në një makinete për kartat OMNY që ndodhet në stacionet e metrosë së NYC Transit;
- Në dyqanet pjesëmarrëse në të gjithë qytetin. Për t'i gjetur këto dyqane pjesëmarrëse, vizitoni <https://omny.info/retail-locations>;
- Duke telefonuar shërbimin ndaj klientit të OMNY-t në numrin 877-789-6669; ose
- Në internet nëpërmjet llogarisë së regjistruar në OMNY (omny.info/register). Gjithashtu, mund të caktoni rimbushje automatike përmes një llogarie OMNY, kështu që nuk do të shqetësoheni më për një bilanc të ulët.

Kthehuni në krye

31. Çfarë është mbulimi i tarifës me FFOC-në time?

Nëse bëni 12 udhëtime me pagesë brenda një periudhe 7-ditore të njëpasnjëshme duke përdorur të njëjtën FFOC, pjesa e mbetur e udhëtimeve brenda së njëjtës javë do të jetë automatikisht pa pagesë. Duhet ta përdorni FFOC-në tuaj për çdo udhëtim individual me pagesë. Gjithashtu, duhet ta përdorni kartën tuaj kur transferoheni, por kjo nuk llogaritet si një nga 12 udhëtimet me pagesë pasi transferimi është pa pagesë. Për më shumë informacione në lidhje me mbulimin e tarifës, vizitoni <https://omny.info/fares>.

Kthehuni në krye

32. Çfarë duhet të bëj nëse më është tarifuar tarifa e plotë dhe jo tarifa e zbritur?

Nëse besoni se po paguani tarifën e plotë, kontrolloni profilin tuaj të OMNY-t duke vizituar OMNY-n në faqen <https://omny.info/register>. Klasa juaj e udhëtarit duhet të lexojë "Fair Fares" dhe do të mund të shikoni udhëtimet që keni kryer dhe keni paguar. Gjithashtu mund të kontaktoni shërbimin ndaj klientit të OMNY-t në numrin 877-789-6669 për të konfirmuar. Nëse nuk e keni klasën e udhëtarit, kontaktoni numrin 311. Nëse e keni klasën e udhëtarit, kontaktoni shërbimin ndaj klientit të OMNY-t.

[Kthehuni në krye](#)

33. Kë duhet të telefonoj nëse kam një pyetje rreth një tarifimi në kartën time OMNY (jo në lidhje me pagesën e tarifës së plotë)?

Kontaktoni shërbimin e klientit të OMNY-t duke telefonuar në numrin 877-789-6669.

[Kthehuni në krye](#)

Përdorimi i kartës së kreditit, kartës së debitit ose pajisjes celulare

34. A mund të përdor kartën time të kreditit ose të debitit, apo pajisjen celulare me zbritjen time të FF-së?

Po. Mund të përdorni kartën tuaj të kreditit ose debitit, apo pajisjen celulare me zbritjen FF. Për ta bërë këtë, identifikohuni te Access HRA (AHRA) dhe zgjidhni "Ndrysho zgjedhjen e zbritjes". Më pas, vendosni numrin e kartës suaj të kreditit ose debitit në mjetin online. Pasi ta bëni këtë, zbritja do të shtohet në llogarinë e tranzitit të kartës suaj të kreditit ose debitit. Kontrolloni AHRA-n për statusin tuaj të zbritjes në faqen nyc.gov/accessfairfares.

Herën tjetër që udhëtoni, prekni kartën e kreditit ose debitit, apo portofolin celular të lidhur me atë kartë. Mund të përdorni zbritjen ose në kartën fizike, ose në pajisjen celulare, por jo te të dyja. Mënyra e parë e pagesës që zgjidhni të përdorni duke kryer prekjën do të përmbajë zbritjen.

[Kthehuni në krye](#)

35. A mund të përdor dy karta krediti ose dy pajisje celulare të ndryshme me zbritjen time FF?

Jo. Nuk mund të përdorni dy karta të ndryshme me zbritjen tuaj. Me OMNY-n do të funksionojë karta ose pajisja e parë që prekni në një lexues kartash OMNY pasi të aktivizohet zbritja. Kini parasysh se të gjitha kartave ose pajisjeve që lidhen me atë numër karte do t'u bllokohet përdorimi i OMNY-t. **Për shembull**, nëse prekni kartën tuaj fizike të kreditit ose debitit, nuk do të mund të përdorni më vonë një portofol celulari me atë kartë. Për të ndryshuar zbritjen, do të duhet të kontaktoni shërbimin ndaj klientit të OMNY-t në numrin 877-789-6669.

[Kthehuni në krye](#)

36. A mund të përdor disa karta udhëtimi në të njëjtën kohë?

Jo. Vetëm një kartë udhëtimi mund të përdoret për të aksesuar zbritjen FF.

[Kthehuni në krye](#)

37. Kë duhet të telefonoj nëse karta ime e kreditit ose debitit nuk funksionon?

Telefononi kompaninë e kartës së kreditit ose bankën që ka lëshuar kartën e kreditit ose të debitit. Nëse karta funksionon kudo por jo në lexuesin e kartave OMNY, kontaktoni shërbimin ndaj klientit të OMNY-t duke telefonuar në numrin 877-789-6669.

[Kthehuni në krye](#)

38. A do të mbahet privat informacioni im?

Po. Ne jemi angazhuar për të mbajtur të sigurt të dhënat tuaja personale.

[Kthehuni në krye](#)

Humbja e kualifikueshmërisë

39. Kam marrë njoftimin se regjistrimi im po përfundon për shkak se nuk kualifikohem më. Mendoj se ka ndodhur një gabim. Me kë mund të flas?

1. Mund ta humbisni kualifikueshmërinë tuaj nëse nuk i përmbushni më kërkesat e kualifikueshmërisë së programit. Mund të vizitoni www.nyc.gov/accessfairfares për të parë arsyen se përse nuk jeni më të kualifikuar.
2. Njoftimi që morët shpjegon arsyen se përse nuk kualifikoheni për FFNYC-në dhe datën e përfundimit të zbritjes suaj. Pas kësaj date, çdo udhëtim i bërë me FFOC-në tuaj do të tarifohet me tarifa të plota.
3. Nëse mendoni që kemi bërë një gabim, vizitoni një [nga zyrat tona](#) ose telefononi numrin 311 për të kërkuar një shqyrtim të aplikimit tuaj.

[Kthehuni në krye](#)

40. Sa kohë kam për të bërë kërkesë për shqyrtimin e përcaktimit të kualifikueshmërisë sime?

Duhet ta kërkon shqyrtimin brenda 14 ditësh nga marrja e njoftimit për ndërprerjen e regjistrimit tuaj. Nëse nuk na kontaktoni, zbritja juaj do të përfundojë në datën e treguar në njoftimin tuaj.

[Kthehuni në krye](#)

41. Çfarë ndodh nëse marr njoftimin se zbritja ime e FFNYC-së do të ndërpritet për shkak të keqpërdorimit ose veprimtarisë së paautorizuar?

Në momentin që konstatohen keqpërdorime ose veprimtari të paautorizuara, zbritja juaj e FFNYC-së do të pezullohet. Nëse keni një FFOC, ajo do të rikthehet në tarifë të plotë. Do ta humbisni kualifikueshmërinë tuaj për FFNYC-në dhe nuk do të keni mundësi të merrni pjesë për 60 ditë në Fair Fares NYC. Duhet të riaplikoni pasi të kalojnë 60 ditë, si dhe duhet të pranoheni si të kualifikuar për të marrë sërish zbritjen e Fair Fares NYC. Kur konstatohen shkelje për herë të dytë për shkak të keqpërdorimit ose mashtrimit, do të përjashtoheni përgjithmonë nga pjesëmarrja në program dhe zbritja juaj do të hiqet. Mund të telefononi numrin 311 nëse keni pyetje.

[Kthehuni në krye](#)

Karta të humbura, të vjedhura, ose të dëmtuara

42. Çfarë të bëj nëse marr një njoftim për bilanc të ulët?

Bilanci i ulët ndodh kur bilanci në kartën tuaj është nën 1,05 \$. Në kartën tuaj do të shtohen para për të udhëtuar me metro ose autobus.

[Kthehuni në krye](#)

43. Sa herë mund ta zëvendësoj FFOC-në time të humbur ose të vjedhur?

FFNYC-ja do të zëvendësojë vetëm FFOC-në e humbur, të vjedhur ose të dëmtuar një herë gjatë çdo viti regjistrimi. Nëse arrini kufirin dhe e humbni kartën tuaj, mund ta blini kartën tuaj OMNY ose ta shtoni zbritjen në një kartë krediti ose debiti.

[Kthehuni në krye](#)

44. Si të veproj nëse FFOC-ja ime ka humbur, është vjedhur ose është dëmtuar?

Identifikohuni në llogarinë tuaj Fair Fares në faqen nyc.gov/accessfairfares dhe klikoni "Report FFNYC OMNY card Lost, Stolen or Damaged (Raporto kartën FFOC si të humbur, të vjedhur ose të dëmtuar)". Ndiqni udhëzimet në ekran.

Gjithashtu, mund të telefononi numrin 311. Pasi raporti juaj të merret, mund të zgjidhni ta zëvendësoni atë me kartën OMNY ose një kartë debiti apo krediti nëse kualifikoheni ende për FFNYC-në.

Nëse e keni raportuar fillimisht kartën tuaj tek OMNY në llogarinë tuaj OMNY ose përmes telefonit, duhet ta raportoni përsëri kartën tuaj te Fair Fares për të marrë një zëvendësuese ose për ta zhvendosur zbritjen në një kartë të re.

[Kthehuni në krye](#)

45. Si të veproj nëse kam humbur kartën e kreditit, kartën e debitit ose pajisjen time celulare me zbritjen?

Nëse humbni kartën e kreditit ose debitit, kontaktoni menjëherë kompaninë e kartës së kreditit ose bankën për të raportuar kartën si të humbur ose të vjedhur. Kjo do ta çaktivizojë kartën. Nëse e humbni pajisjen tuaj celulare, ndiqni udhëzimet e prodhuesit për të çaktivizuar pajisjen.

Pasi të ndërmerrni këto hapa, identifikohuni në Access HRA dhe zgjidhni "Ndrysho zgjedhjen e zbritjes" për ta zhvendosur zbritjen në një kartë ose pajisje të re. Duhet të keni një numër të ri karte para se të ndryshoni përzgjedhjen e zbritjes suaj.

[Kthehuni në krye](#)

46. Si ta zhvendos bilancin nga karta ime OMNY e humbur, e vjedhur, e dëmtuar, e skaduar ose afër skadencës në kartën time të re OMNY?

Nëse Fair Fares po e zëvendëson kartën tuaj të vjetër OMNY me një të re, nuk duhet të bëni asgjë. Bilanci juaj do të zhvendoset automatikisht nga karta juaj e vjetër në të rene.

Nëse po e zëvendësoni kartën OMNY me një kartë OMNY që e keni blerë vetë, duhet të telefononi shërbimin ndaj klientit të OMNY-t dhe të zhvendoseni bilancin tuaj nga karta e vjetër në të rene. Mund të telefononi shërbimin ndaj klientit të OMNY-t në numrin 877-789-6669. Kur telefononi, duhet të jepni adresën e email-it ose kodin postar që lidhet me llogarinë tuaj të OMNY-t. Nëse nuk keni një llogari OMNY, duhet të jepni numrin e kartës ose numrin e llogarisë tranzit për kartën OMNY të humbur, të vjedhur, të dëmtuar, të skaduar ose afër skadencës. Mund ta gjeni numrin e llogarisë tranzit në llogarinë tuaj të Access HRA ose duke telefonuar në numrin 311.

Kini parasysh që nuk mund të merrni një rimbursim për një kartë OMNY të humbur ose të vjedhur. Vetëm mund ta zhvendosni bilancin e mbetur në një kartë zëvendësuese.

[Kthehuni në krye](#)

Rinovimet

47. Sa shpesh duhet ta rinovoj regjistrimin tim në FFNYC?

Duhet ta rinovoni regjistrimin tuaj në FFNYC një herë në vit. Duhet të kualifikoheni për programin në kohën e rinovimit në mënyrë që zbritja juaj e FFNYC-së të rinovohet.

[Kthehuni në krye](#)

48. Si mund ta rinovoj regjistrimin tim në FFNYC?

Identifikohuni në llogarinë tuaj në faqen nyc.gov/accessfairfares për të rinovuar regjistrimin tuaj në FFNYC pasi të merrni një njoftim për rinovim nga Fair Fares. Bëjeni këtë rinovim të paktën 30 ditë përpara përfundimit të regjistrimit tuaj për të shmangur boshllëqet në zbritjen tuaj.

[Kthehuni në krye](#)

49. A do të njoftohem kur duhet të bëj rinovim?

Po. Do t'ju dërgojmë një njoftim me postë dhe me mesazh kur të vijë koha për të rinovuar. Do të përdorim adresën postare që keni dhënë te Fair Fares NYC. Mund të kontrolloni faqen kryesore të Fair Fares NYC për përditësimet dhe afatet në çdo kohë.

[Kthehuni në krye](#)

50. A ka një afat për rinovimin?

Po. Njoftimi i rinovimit do të tregojë afatin tuaj për të rinovuar. Nëse nuk rinovoni brenda afatit, duhet të dërgoni një aplikim të ri. Kontrolloni llogarinë tuaj FFNYC për informacion rreth regjistrimit tuaj.

[Kthehuni në krye](#)

51. Çfarë ndodh nëse nuk e arrij afatin e rinovimit?

Nëse e humbisni afatin e rinovimit, do t'ju duhet të dërgoni një aplikim të ri. Kjo do të pezullojë përkohësisht zbritjen tuaj. Gjatë kohës kur llogaria juaj të jetë e pezulluar, do të paguani tarifën e plotë nëse provoni ta përdorni. Zbritja juaj do të fillojë pasi ta rinovoni ose të riaplikoni dhe pasi aplikimi juaj të pranohet.

[Kthehuni në krye](#)

52. Si ta di nëse kualifikohem për FFNYC-në?

Vizitoni nyc.gov/fairfares për të kontrolluar kualifikueshmërinë tuaj. Për të rinovuar regjistrimin tuaj në programin FFNYC, duhet të vazhdoni të plotësoni kërkesat e kualifikueshmërisë të FFNYC-së.

[Kthehuni në krye](#)

53. Po nëse adresa ime e re nuk është në qytetin e Nju-Jorkut?

Vetëm banorët e qytetit të Nju-Jorkut kualifikohen për programin Fair Fares NYC.

[Kthehuni në krye](#)

54. Çfarë dokumentesh duhet të dorëzohet bashkë me aplikimin për rinovim?

Referojuni listës së dokumenteve të nevojshme në faqen e internetit të Fair Fares NYC.

[Kthehuni në krye](#)

55. A do të pajisem me një kartë të re Fair Fares NYC OMNY kur të bëj rinovimin?

Do të vazhdoni të përdorni FFOC-në që është lëshuar për ju, përveçse nëse keni humbur kartën tuaj ose nëse asaj po i afrohet data e skadencës. FFOC-ja juaj do të jetë e vlefshme për disa vite.

[Kthehuni në krye](#)

56. A do të jem në gjendje të vazhdoj ta përdor zbritjen aktuale të FFNYC-së pasi të miratohet aplikimi im për rinovim?

Po. Do të mund të vazhdoni ta përdorni zbritjen tuaj aktuale të FFNYC-së deri sa të skadojë regjistrimi juaj. Edhe kur regjistrimi juaj të skadojë (kjo nënkupton që nuk jeni më të kualifikueshëm për programin), mund të vazhdoni ta përdorni kartën tuaj OMNY për të paguar tarifën e plotë.

[Kthehuni në krye](#)

Kartat e skaduara

57. Si mund ta kuptoj kur karta FFNYC është afër skadencës?

Data e skadimit ndodhet në pjesën e pasme të kartës suaj.

[Kthehuni në krye](#)

58. Çfarë ndodh nëse FFOC-ja ime skadon në më pak se 30 ditë?

Meqenëse FFOC-ja ka një datë skadimi më të vonë sesa FFMC-ja, FFOC-ja do të zgjasë për disa vite. Duhet të vazhdoni ta përdorni kartën tuaj derisa ajo të skadojë. Nëse jeni ende të regjistruar në program dhe kartës suaj aktuale OMNY po i afrohet data e skadimit, FFNYC-ja do t'ju dërgojë automatikisht me postë një kartë të re afërsisht 30 ditë para skadimit të kartës suaj aktuale. Kur të merrni kartën tuaj zëvendësuese OMNY, mund ta transferoni bilancin nga karta juaj e skaduar në FFOC-në tuaj duke kontaktuar shërbimin ndaj klientit të OMNY-t në numrin 877-789-6669.

[Kthehuni në krye](#)

59. Çfarë ndodh nëse karta ime e debitit ose e kreditit me zbritje skadon?

Nuk ndryshon asgjë. Karta dhe zbritja juaj do të vazhdojnë të funksionojnë me OMNY-n.

[Kthehuni në krye](#)

60. A mund të përdor një FFOC të skaduar nëse ka ende para brenda?

Jo. Karta juaj OMNY nuk do të funksionojë pas datës së skadimit. Kur FFOC-ja skadon, bilanci juaj do të zhvendoset automatikisht te karta e re që merrni me postë.

[Kthehuni në krye](#)

Telefononi numrin 311 nëse keni ndonjë pyetje për programin Fair Fares NYC. Gjithashtu, mund të vizitoni nyc.gov/fairfares për më shumë informacion në lidhje me programin Fair Fares NYC.